



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR

TIRANË

NR. AKTI 2150

NR. VENDIMI 3484



REPUBLIKA E SHQIPERISË  
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR TIRANË

Nr. Akti 2150

Nr. Vendimi 3484

Datë regjistrimi 07 shtator 2015  
2016

Datë vendimi 26 prill

*V E N D I M*  
*" NË EMËR TË REPUBLIKËS "*

Gjykata e Rrethit Gjyqësore Tiranë me trup gjykues të përbërë nga :

*Rezarta MATAJ ----- Gjyqtare*

me sekretare seance Elona Molla, në Tiranë, sot më datë 26 prill 2016, ora 15:00 pasi mori në shqyrtim në disa seanca të veprimeve përgatitore me dyer të hapura çështjen civile që i përket :

*Paditës: Shoqëria "\*\*\*\*" sha me NUIS \*\*\*.a me adresë në \*\*\*, adminstrator \*\*\* i cili përfaqësohet në gjykim me autorizim nga av. \*\*\* antarë e Dhomës së Avokatisë Tiranë.*

*I paditur: Shoqëria " \*\*\*\*" shpk me NUIS \*\*\* me adresë në \*\*\*me administrator \*\*\*.*

*Me person të tretë: Drejtoria e Përgjithshme e Markave dhe Patentave (në mungesë) dhe Avokatura e Shtetit Zyra Vendore Tiranë (në mungesë).*  
*2. Qendra Kombëtare e Regjistrimit (në mungesë).*

*Me objekt: Konstatimin e konkurrencës së pandershme si pasoje e përdorimit të paautorizuar të markës tregtare Ndalimin e subjektit tregtar \*\*\* të perdore marken tregtare AIBA Shperblimin e demit të shkaktuar nga shkelesi i te drejtave të pronësive industriale ne masen \*\*\*leqe Detyrimin e QKR per c' regjistrimin nga regjistri tregtar emrin e subjektit tregtar \*\*\* shpk si dhe rregjistrimin e tij, me nje emer jo te ngjashem me emrin e shoqerise \*\*\*sha.*

-

Baza ligjore:

Neni 348 i Kodit të Proçedurës Civile, neni

638,639

të Kodit Civil, ligji nr. 9947/2008 2008 "Për pronësinë industriale" i ndryshuar, neni 156 e vijues.

-Në bisedimet përfundimtare pala paditëse kërkoi: "Pranimin e kërkesë padisë, sipas objektit dhe pagimin e shpenzimeve avokature duke paraqitur edhe faturën tatimore për shërbimin".

-Pala e paditur u shpreh: "Rrëzimin e padisë".

- Personat e tretë në mungesë.

-Gjykata pasi mbylli hetimin gjyqësori, konsultoi çështjen në ligj, prova dhe bindjen e saj të brëndshme

VËRËN se

1. Paditësi Shogëria "\*\*\*\*" sh.a i drejtohet Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (më tej GJRRGJ Tiranë) me kërkesë-padinë me palë të paditur "\*\*\*\*" shpk, objekt, shkak ligjor si në pjesën hyrëse të këtij vendimi.

2. Gjykata sipas nenit 348 të Kodit të Proçedurës Civile (më tej KPRC) vlerëson se ka juridiksionin gjyqësor, kompetencën tokësore dhe lëndore në gjykimin e kësaj kërkesë-padie pasi është seksioni tregtar i kësaj Gjykate e cila gjykon të gjitha mosmarrëveshjet që rrjedhin nga patentat, markat tregtare dhe të shërbimit, dizenjt tregtare, modelet dhe çdo e drejtë tjetër që rrjedh nga pronësia industriale për tërë territorin e Republikës së Shqipërisë.

3. Sipas nenit 193 të KPRC, Gjykata e vlerësoi të nevojshme paraqitjen edhe të DPPM dhe të QKR-së për të qënë në gjykim pasi kjo vendimarrje mund të prek interesat apo të urdhëroj zbatimin e vendimit.

4. Sipas nenit 35 të KPRC kjo çështje gjyqohet nga një gjyqtar pasi vlera e objektit të padisë është nën 20 milion lekë.

II. Mbi faktet dhe rrethanat e çështjes të provuara në gjykim

4. Paditësi është krijuar me \*\*\*\*.1994 dhe ka fushë të veprimtarisë së tij pridhim e tregtim të vezëve, mbarështim e tregtim të zogjëve, ushqimeve blegtorale, pleh organik, ushqime etj. Me territor të veprimtarisë në Durrës, Tiranë Kamëz dhe në \*\*\*\*, në Burrel, Elbasan, Kavajë etj.

5. Pala e paditur është krijuar me datë \*\*\*\*.2005 dhe ka veprimtari të saj, pulari, mbarështim e prodhim vezësh, tregtim të artikujve ushqimor etj. me territor të veprimtarisë në Bajzë Shkodër, Kashar Tiranë etj.

6. Me apikimin e daës 23 mars 2012 rezulton se paditësi ka regjistruar markën me nr. \*\*\*\* emër dhe logo me ngjyrë të gjelbër, verdhë dhe gri me një trekëndësh të futur në pjesën fundore të një paralelopipedi me emri "aiba" për mallin vezë. Në logo është edhe fjala "Company" e përjashtuar nga mbrojtia.

7. Nga kërimi i bërë në DPPM nuk rezulton se \*\*\*\* shpk të ketë regjistruar markë apo logon e saj që nga 1995 e deri me datë 26 maj 2015 kur është bërë verifikimi.

8. Vezët e prodhura nga \*\*\*\*sha rezultojnë se kanë logon e kuqe sipas kërkesave të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit "AIBA Co L" AL 06/02 me ngjyrë rozë dhe me logo të ambalazhit të vezëve aiba compay me logon përkatëse të regjistruar, 10 vezë, me pamje të fshatit, ambalazh i verdhë me leimin 10 vezë të freskëta si dhë në gjuhën italiane "uova

fresche”.

9. Sipas shpjegimeve të paditëses, rezulton se në mbikalimin e Kamzës në Tiranë, është kapur një shitës me ambalazhin e kutive të pikerinave të vezëve të stampuara me ” \*\*\*” sh.a ndërsa në brëndësi të saj kishte vezë me stampim ALBA L 0022/02 me ngjyrë të rozë. Për këtë fakt është bërë edhe një kallzim penal për të cilën hetimet po vazhdojnë nga Prokuroria pranë GjRREGJ Tiranë.

10. Sipas prapësimeve të të paditurit, ai ka krijuar shoqërinë dhe i ka vënë emrin e bashkëshortes së tij nga Albana shkurt në ALBa Company shpk. Për këtë ai solli edhe certifikatën e familjes ë tij datë 26 ënntor 2015 e lëshuar nga ZGJC kastrat Malsi e Madhe. Ai pranoi se tregton vezë dhe ka logon sipas etiketës së miratuar nga AKU Shkodër, me një pulë me shënimin ”Alba, provoje që ta shijosh” dhe me sfond fushë dhe horizont, qiell etj.

11. I padituri u shpreh gjatë gjithë gjyqimit se gjyqi që ka ngritur pala paditëse është absurd, ai është regjistruar pranë QKR-së dhe kjo nuk i k bërë me dije se është një emër që nuk duhet të përdoret për shoqërinë, po ashtu emrin e ka marrë nga shkurtimi i emrit të bashkëshortes së tij dhe jo për të kopjuar AIBA co shpk. Zakonisht territori i shitjes së vezëve ka qënë në Shkodër porse ai nuk mban përgjegjësi se ku shiten vezët nga ata nëpër Shqipëri.

11.2 I padituri u shpreh se që nga data kur është ngritur kjo padi në pritje të vendimarrjes së Gjykatës nuk ka tregtuar asnjë vezë më.

12. Paditësi u shpreh se kjo konkurrencë e pandershme i ka shkaktuar humbje dhe për këtë arsye duhet të shpërblehet me \*\*\*lehtë për dëmin pasuror dhe jopasuror të shkaktuar shoqërisë dhe të ndaloj të përdor këtë emër në vezë, logo etj.

13. Paditësi u shpreh se ka kontraktuar me datë 01 mars 2012 me \*\*\* sh.a për reklamë në shumën prej \*\*\*euro gjatë spektaklit \*\*\* dhe të ofroj me këto produkte banorëts, me datë 01 qershor 2015 me \*\*\* lehtë për 10 ditë mes disa telenovelave, me datë 15 prill 2015 me \*\*\* për gjashtë muaj në shumën prej \*\*\* euro disa televizione për të bërë reklamë vezëve të tij e për këtë ka pasur edhe shpenzimeë nga data kur është ngritur kjo padi në pritje të vendimarrjes së saj.

### III. Legjislaconi i zbatueshëm

14. Kodi Civil i ndryshuar.

Neni 638 -Konkurrenca e pandershme

“Në varësi të dispozitave që kanë lidhje me mbrojtjen e shënjave dalluese dhe të drejtave të patentës, veprimet e konkurrencës së pandershme kryhen prej cilitdo që:

1. përdor emrat ose shënjat dalluese të cilat mund të sjellin ngatërresë me emrat dhe shënjat dalluese të përdorura ligjërisht nga të tjerë, ose imiton produktet e një konkurrenti ose kryen veprime të cilat mund të sjellin ngatërresa me produktet dhe veprimtarinë e një konkurrenti;

2. trajton si të vetat cilësitë e produkteve ose të ndërmarrjes së konkurrentit;

3. përdor vetë drejtpërsëdrejti ose tërthorazi çdo mjet tjetër që nuk përputhet me parimet e ndershmërisë profesionale dhe mund të dëmtojë veprimtarinë e tjetrit.”

Neni 639

“Vendimi që vërteton veprime të konkurrencës së pandershme ndalon vazhdimin e tyre dhe përcakton masat e nevojshme me qëllim që të zhduken pasojat.

Në qoftë se këto veprime janë kryer me faj, personi që i ka kryer detyrohet të shpërblejë dëmin.

Neni 608 -Përgjegjësia për shkakëtimin e dëmit

“Personi që, në mënyrë të paligjshme dhe me faj, i shkakton tjetrit një dëm në personin ose në pasurinë e tij, detyrohet të shpërblejë dëmin e shkakëtuar.

Personi që ka shkakëtuar dëmin nuk përgjigjet kur provon se nuk ka faj.

Dëmi quhet i paligjshëm kur është rrjedhim i shkeljes ose i cenimit të interesave dhe i të drejtave të tjetrit, që mbrohen nga rendi juridik ose nga zakonet e mira.

Neni 609

“Dëmi duhet të jetë rrjedhim i drejtpërdrejtë dhe i menjëhershëm i veprimit ose mosveprimit të personit.

Mospengimi i një ngjarjeje nga personi që ka detyrimin ligjor për ta mënjauar, e ngarkon atë me përgjegjësi për dëmin e shkakëtuar.”

“Në një kontratë, shkaqë ligjor është i paligjshëm kur vjen në kundërshtim me ligjin, rendin publik, ose kur kontrata bëhet mjet për të shmangur zbatimin e një norme”.

15. Ligji 9947 datë 07 korrik 2008 “Për pronësinë industriale” i ndryshuar

Neni 156 -Të drejtat që rrjedhin nga regjistrimi

“1. Pronari i markës së regjistruar gëzon të drejtën ekskluzive të përdorimit të markës, në përputhje me të drejtat e parashikuara në këtë ligj.

2. Pronari i markës së regjistruar gëzon të drejtën të ndalojë personat e tretë të përdorin, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre tregtare, pa autorizimin e tij:

a) një shenjë, që është e njëjtë me markën, për mallra dhe shërbime, që janë të njëjta me ato, për të cilat është regjistruar marka;

b) një shenjë, që është e njëjtë ose e ngjashme me markën apo që, për shkak të njëllojshmërisë apo ngjashmërisë së mallrave ose shërbimeve, për të cilat përdoret shenja, me mallrat apo shërbimet, që mbulohen nga marka e regjistruar, mund të shkaktojnë konfuzion të publiku, ku përfshihet edhe mundësia e bashkëlidhjes së shenjës me markën tregtare;

c) një shenjë të njëjtë ose të ngjashme për mallra apo shërbime, edhe kur këto nuk janë as të njëjta e as identike me ato, për të cilat është regjistruar marka, në rast se marka ka reputacion në Republikën e Shqipërisë dhe nga përdorimi i shenjës, pa shkak të arsyeshëm, realizohet një përfitim i padrejtë ose dëmtohet natyra dalluese apo emri i mirë i markës.

3. Në përputhje me pikën 2 të këtij neni, gjithashtu, ndalohet:

a) vendosja e shenjës te mallrat ose ambalazhet e tyre;

b) hedhja e mallrave në treg, ofrimi i tyre për shitje, duke përdorur këtë shenjë, ose krijimi dhe mbajtja e rezervave për këto qëllime;

c) ofrimi i shërbimeve, duke përdorur këtë shenjë;

ç) importimi ose eksportimi i mallrave, duke përdorur këtë shenjë;

d) përdorimi i shenjës në veprimtarinë tregtare, në reklamime ose publicitete.

4. Të drejtat, që i njihen pronarit të markës së regjistruar, sipas këtij neni, i njihen edhe pronarit të markës së mirënjohur në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me përcaktimin e shkronjës “ç” të pikës 5 të nenit 143 të këtij ligji. “

#### IV. Vlerësimi dhe analiza e çështjes sipas ligjit dhe provave

16. Përgjegjësia jashtëkontraktore për shkak të konkurrencës së pandershme është e lidhur ngushtësisht me mbrojtien që njeh personi nga ligji për të pronësinë industriale e shfaqur në formën e markave tregtare, dizenjove industriale, patentave etj.

17. Të konkurosh në treg ekonomikisht do të thotë të "garash" me të njëjtën "kundërshtar" që tregtojnë të njëjtët mallra apo shërbime në treg por duke qënë i hapur, duke zbatuar rregullat e tregut, ligjet e vendit pa krijuar një pozitë dominuese në disfavor të tjetrit nëpërmjet veprimeve të kundërligjshme apo që bien ndesh me zakonet e mira tregtare. Neni 638 i KC Konkurrencën e pandershme e përkufizon kur:

1. përdor emrat ose shënjat dalluese të cilat mund të sjellin ngatërresë me emrat dhe shënjat dalluese të përdorura ligjërisht nga të tjerë, ose imiton produktet e një konkurrenti ose kryen veprime të cilat mund të sjellin ngatërresa me produktet dhe veprimtarinë e një konkurrenti;  
2. trajton si të vetat cilësitë e produkteve ose të ndërmarrjes së konkurrentit;  
3. përdor vetë drejtpërsëdrejti ose tërthorazi çdo mjet tjetër që nuk përputhet me parimet e ndershmerisë profesionale dhe mund të dëmtojë veprimtarinë e tjetrit.

18. Rezulton se paditësi ushtron veprimtarinë e tij kryesisht në mbarështimin e pulave dhe tregtimin e vezëve etj. Për ta identifikuar mallin e tij, vezët ai ka regjistruar markën tregtare pra shënjen dalluese me titullin aiba me tre ngjyra dhe me trekëndësh dhe me paralelopiped. Kjo markë është e vendosur kryesisht në ambalazh të kutive të vezëve, markë fonetike është e vendosur me ngjyrë të rozë në vezë etj. Të drejtën e përdorimit të kësaj marke pra me pamje dhe me shkronja i ka efektet e regjistrimit që në momentin e aplikimit sipas nenit 146 të ligjit nr.9947/2008, ne rastin konkret që me datë 23 mars 2012.

19. Sipas nenit 156§2,b të ligjit në nr.9947/2008 për shkak të regjistrimit i pari të kësaj marke, pronari fiton pronësinë njësoj si mbi një send të luajtshëm a të paluajtshëm dhe ka të drejtë të ndaloj çdo person që përdor në ushtrim të veprimtarisë së tij tregtare shenjë të njëjtë a të ngjashme me markën e tij ku për shkak të njëllorshmërisë së shërbimit, konsumatori konfondohe.

20. Rezulton se pala e paditur ushtron veprimtari tregtare, kjo e provuar nga ekstrati historik i QKR-së ku është regjistruar me emrin tregtar \*\*\*shpk, ka fushë veprimtaria tregtare të njëjtë si pala paditëse atë të mbarështimit të pulave, tregtimin të vezëve etj. Rezulton e pala e paditur nuk ka ndonjë markë të regjistruar për mallrat që ai tregon.

21. Së pari- Gjykatë vlerëson e edhe një shtetas me intelekt mesatar do të konfondodet kur në treg të shikoj vezët e tregtuara nga pala paditëse \*\*\*shpk nga \*\*\*shpk për faktin se: vizualisht në lëvozhgën e vezëve të dy shoqëritë përdorin me ngjyrë të rozë në shkronja kapitale emërtimin AIBA dhe tjetra ALBA. Ndërsa në logon e pikerinave apo paketimit logoja e palës së paditur është e shkruar në shkronja të vogla shtypi ky shkronja "l" konfondohet dukshëm me shkronjën "i" pra shfaqet në ambalazhim veza "aiba" dhe "alba".

21.1 Këto shkronja ¾ janë identike ndërsa I dhe L janë tepër të ngjashme madje për personat që mund të kenë probleme me shikimin duken edhe të njëjta për shkak të madhësisë së vogël në to dhe ngjyrës rozë të njëjtë.

22. Së dyti- Për gjykatën nga pikëpamja fonetike shqiptimi i logos AIBA është tepër i ngashëm me ALBA aq më tepër që të dyja shoqërohen me një emërtim të përgjithëm Kompani duke konfonduar konsumatorin vizualisht dhe fonetikisht se kemi të bëjme me

vezë të AIBA Kompani shpk të Shijak Durrës apo të ALBA Company (shqiptohet kompani) të Bajzë Malsi e Madhe.

23. Së treti- plotësohet edhe kushti i tretë i konkurrencës së pandershme se malli është i njëjtë, vezë dhe përgjithësisht me lëvizshmëri të bardhë dhe më logon rozë lartë.

24. Së katërti- Për shkak të reklamimeve të shpeshta të vezës aiba në emisione të ndryshme në televizione kombëtare shqiptare është evidente se pala e paditur ka përfituar nga marka me reputacion të njohu në Republikën e Shqipërisë dhe ka zgjedhur pikërisht këtë emërtim për të vendosur tek veza që ai tregton. Prapësimin e palës së paditur që ka zgjedhur shkurtim të emrit të bashkëshortes e gjen të pambështetur pasi ai nuk ka vënë emrin e plotë të saj, Albana dhe as shkurtimin e zakonshëm për këtë emër "bana" por për të konfunduar konsumatorin me një markë të mëparshme të mirënjohur ka përzgjedhur emrin "alba".

25. Si përfundim gjykata e gjen me vënd pretendimin e paditësit se kemi konkurrencë të pandershme nga pala e paditur mbi tregtimin e vezëve. PO ashtu gjen të drejtë pretendimin e paditësit sipas nenit 639 të KC që të merren masa për zhdrukjen e kësaj konkurrence.

26. Kështu gjykata ndalon palën e paditur të mos e përdor më logon dhe emrin tregtar "alba" dhe \*\*\*shpk në tregtimin e vezëve të tij pasi konfundon konsumatorin. Në përputhje me nenin 156 pika 3 e ligjit të posaçëm të paditurit, konkurrentit të pandershëm i ndalohet: vendosja e shenjës te mallrat ose ambalazhet e tyre;

...

importimi ose eksportimi i mallrave, duke përdorur këtë shenjë;

përdorimi i shenjës në veprimtarinë tregtare, në reklamime ose publicitete.

27. Gjykata vlerësoi se meqënëse pala paditëse ka hequr mallin gjatë gjykimit të kësaj çështje dhe nuk tregton më këtë mall në pritje të vendimit të gjykatës nuk ka pse të jap masa të tjera që parashikon neni 156§3 i ligjit siç është ajo e ndalimit të hedhjes së mallrave, shitjes etj.

#### IV. Mbi shpërblimin e dëmit

28. Paditësi në referencë të nenit 638, 639 të KC në mënyrë alternative mund të shpërblej edhe dëmet që mund të ketë pësuar i konkurreuari nga konkurrenca e pandershme.

29. Së pari për gjykatën konkurrenca e pandershme kërkon dashje direkte, qëllim të drejtëpërdrejtë për të ulur fitimet e palës konkurrente dhe për të shtuar fitimete tij. Me veprimet e palës së paditur i cili ka hequr menjëherë vezët nga tregu, nuk ka tregtuar më të tillë vezë me logon alba edhe pse kishte tre muaj që i kishte nxjerrë në treg për herë të parë tregon se ai nuk ka vepruar me keqdashje. Ky element është i domosdoshëm në shpërblimin e dëmit për konkurrencën e pandershme sipas nenit 639 të KPRC. Pra termi faj nuk duhet interpretuar gjerësisht por vetëm në rastin kur kemi dashje direkte.

30. Së dyti- fakti se paditësi ka kryer disa fushata publicitare në disa vite nuk bëhet lidhja me faktin se kjo është për shkak të rënies së shitjeve nga një konkurrencë e pandershme. Madje ka diferencë mes periudhave kur janë bërë reklamimet 2012, 2013 etj. dhe kohës kur është zhvilluar konkurrenca e pandershme.

31. Pretendimin për dëm të pësuar nga paditësi në masën \*\*\*lekë gjykata nuk e gjen të drjetë e të mbështetur. Paditësi dështoi në provimin përpara gjykatës se çfarë dëmi pasuror, jopasuror ka pësuar " \*\*\*" shpk me veprimtari në shumë qytete të Shqipërisë nga tregtimi i vezëve në Tiranë dhe Shkodër nga " \*\*\*". PO ashtu gjykata nuk gjen lidhje mes

shpenzimeve të bëra për fushatë marketingu të paditësit me kohën kur ka ndodhur konkurrenca e pandershme. Pra për gjykatën nuk është e qartë nëse këto reklamime janë bërë në kuadër të grafikut normal të marketingut të vezës së kësaj shoqërie apo posaçërisht për shkak të ndodhjes së konkurrencës dhe humbjes së reputacionit të mirë.

32. Për këtë arsye, gjykata vendos rrëzimin e këtij prentedimi si të pambështetur në ligj dhe në prova.

33. Në lidhje me efektet e tjera në gjykim, në përputhje edhe me ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, palës paditëse duke qënë se ka të njëjtën fushë të veprimtarisë me shoqërinë "\*\*\*\*" shpk dhe emri tregtar përdoret gjërësisht në marketing, lidhje kontratash etj. detyrohet të ndryshoj edhe emrin tregtar të shoqërisë së tij për shkak se është regjistruar më mbrapa dhe ngatërron konsumatorin se me cilën shoqëri po lidh kontratat, vezët e cilës shoqëri po blen etj.

33.1 Sipas ligjit nr. 9901/2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, neni 4 "1. Tregtari dhe shoqëritë tregtare e ushtrojnë veprimtarinë e tyre nën emrin e regjistruar. Emri i tregtarit është emri i tij, sipas nenit 5 të Kodit Civil, i regjistruar në përputhje me nenin 30 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Emri i shoqërisë tregtare duhet të jetë në përputhje me parashikimet e nenit 23 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

2. Tregtari dhe shoqëritë tregtare mund të përdorin dhe emërtime tregtare, si dhe shenja të tjera dalluese të veprimtarisë dhe i regjistrojnë këto në përputhje me nenin 44 pika 1 shkronja "a" të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

33.2 Sipas nenit 5 të KC që rregullon emrin për personin fizik parashikohet se personit të cilit i mohohet e drejta e përdorimit të tyre ose çënohet nga përdorimi që të tjerët i bëjnë padrejtësisht, mund të kërkojë në gjykatë përdorimin e emrit ose të mbiemrit të vet, pushimin e cenimit, si dhe shpërblimin e dëmit përkatës. Për gjykatën emrat pothuaj të ngjashëm mes dy shoqërive tregtare që ngatërrojnë konsumatorin nuk duhet të ekzistojnë dhe shoqëria që ka regjistruar shoqërinë më e fundit duhet të pushoj çënimin emrit të të parës duke zgjedhur një emërtim të ri.

34. Në lidhje me shpenzimet gjyqësore gjykata konstaton se fatura tatimore e shitjes sipas ligjit për kontabilitetin nuk është e nënshkruar nga blerësi i shërbimit për këtë arsye nuk provohet se sa është shpenzimi i bërë nga paditësi për avokaten dhe ky shpenzim mbetet i paprovuar. Ndërsa shpenzimet të tjera sipas nenit 106 të KPRC i ngarkohen të paditurit në përpjestim me pranimin e padisë. Kjo edhe në përputhje me jurisprudencën e GJEDNJ Strasburg ku shpenzimet duhet të jenë të arsyeshme, të drejta, të lidhura me objektin e gjykimit dhe të provuara.

#### PËR KËTO ARSYE

Gjykata bazuar në nenet 126,306-310,102-106 të Kodit të Procedurës Civile si dhe nenet 156 e vijues të ligjit nnr. 9947/2008 "Për pronësinë industriale" i ndryshuar si dhe ligji nr. 9723/2007 "Për qendrën kombëtare të regjistrimit" i ndryshuar

#### V E N D O S I

Pranimin e pjesshëm të padisë.

Konstatimin e konkurrencës së pandershme në formën e tregtimit të vezë me logon "Alba" të kryer nga ana e palës së paditur "\*\*\*\*" shpk ndaj palës paditëse "\*\*\*\*" shpk pronare e markës tregtare të regjistruar me nr. \*\*\* datë \*\*\*.

Detyrimin e palës së paditur Shogëria "\*\*\*\*" shpik që të ardhmen të:

· mos tregtoj, shes, eksportoj etj. vezë me logon "Alba";

· të mos vendos shenjë "Alba" te tek ambalazhet e tyre e vezëve që tregton;

· Të mos e përdor shenjen Alba-Company në veprimtarinë tregtare, në reklamime.

· brenda 30 ditëve nga marrja formë e prerë e këtij vendimi të nrdyshoj edhe emrin tregtar "\*\*\*\*" shpik në një emër tjetër jo të ngjashëm me emrin tregtar të palës paditëse.

Rrëzimin e padisë për pejsën tjetër si e pambështetur në ligj dhe në prova.

Bashkë me këtë vendim lëshohet urdhëri I ekzekutimit.

Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të palës së paditur në përjestim me pranimin e padisë.

Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Apelit Tiranë brenda 15 ditëve nga nesërmja e shpalljes së këtij vendimi për palët e tjera në mungesë ky afat fillon nga nesërmja e njoftimit të këtij vendimi.

U shpall në Tiranë sot me date 26 prill 2016!

Sekretare gjyqësore

Gjyqtare

---

Elona Molla

Rezarta MATAJ

SHPENZIMET GJYQËSORË

(Sipas neneve 102 dhe 106 të K. Pr. Civile)

<u>Takshë regjistrimi</u>	<u>*** Lekë</u>
<u>Takshë aktesh noteriale</u>	<u>*** Lekë</u>
<u>Për njoftime</u>	<u>*** Lekë</u>

TOTALI i SHPENZIMEVE: \*\*\* Lekë

(\*\*\*)

Sekretarja Gjyqësore

---

Elona Molla